Kronikë

Kultivuan kanabis në tokën e tyre, shpallen në kërkim dy vëllezërit në Shkodër, në banesë u gjendet një kallashnikov

Dy vëllezër në Shkodër janë shpallur në kërkim si autorë të dyshuar të kultivimit të bimëve narkotike

HOROSKOPI

RAPORTO! Chat live me Shqiptarja.com

[Sh.com] Redaksia
6 Tetor, 16:00 | **Përditesimi: 6 Tetor, 17:52**

Share

Dy vëllezër në Shkodër janë shpallur në kërkim si autorë të dyshuar të kultivimit të bimëve narkotike. Policia raporton se nga kontrollet, në një miniparcelë në afërsi të banesës së dy vëllezërve, u gjetën 70 bimë narkotike cannabis sativa, në proces tharjeje, ndërsa në ambientet e banesës, u gjet një armë zjarri kallashnikov dhe 17 fishekë.

Njoftimi i policisë

[Sh.com]

LEXO EDHE:
Brazil, Task Forca e EUROPOL-it, 'Balkan Cartel' njofton se u kap një krye-trafikant serb i drogës

Kontrollet e mbështetura nga inteligjenca policore, bëjnë të mundur sekuestrimin e një arme zjarri kallashnikov dhe të disa fishekëve, si dhe asgjësimin e 70 bimëve cannabis sativa, në proces tharjeje. Policia vijon punën për kapjen e 2 vëllezërve, të cilët u identifikuan si autorë të dyshuar të kultivimit të bimëve narkotike dhe të posedimit të armës së zjarrit. Si rezultat i patrullimeve të vazhdueshme në të gjithë territorin e qarkut, me qëllim garantimin e rendit dhe sigurisë publike, si dhe për parandalimin dhe goditjen e veprimtarive kriminale, shërbimet e Komisariatit të Policisë Shkodër kanë siguruar informacion se 2 shtetas kishin kultivuar bimë narkotike, në pronën që kishin në fshatin Vuksanaj.

Shërbimet e Policisë kanë organizuar punën dhe kanë kryer kontrolle në banesën e këtyre shtetasve dhe në zonën përreth. Nga kontrollet, në një miniparcelë në afërsi të banesës, u gjetën 70 bimë narkotike cannabis sativa, në proces tharjeje, ndërsa në ambientet e banesës, u gjet një armë zjarri kallashnikov dhe 17 fishekë. Në vijim të veprimeve procedurale për këtë rast u shpallën në kërkim 2 vëllezërit, pronarë të banesës, shtetasit T. M., 29 vjeç dhe F. M., 27 vjeç, të dy banues në fshatin Vrakë, Malësi e Madhe. Policia vijon punën për lokalizimin dhe për kapjen e tyre.

B.K/KT/Shqiptarja.com

TAG: Shkoder droge

Komento

© Ndalohet rreptësisht ripublikimi i këtij shkrimi, sipas nenit 80, ligji 35/2016

SH.com

Sondazhi i ditës:
Vdekja e 3-vjeçarit, a duhen bërë kontrolle të rrepta në klinikat private?

PO JO NUK E DI

Lajme të tjera

Shkodër/ Vuante nga miokardi në zemër, vdes foshnja 8-muajshe! Ngjarja para 2 javësh, prindërit padisin mjekët
Ergys Kavaja
6 Tetor, 13:02

'Klasikja' Vllaznia - Tirana luhet në Kukës, Migen Memelli: Kemi dy rikthime, bardheblutë janë skuadër e dashur për mua
6 Tetor, 10:29

Shkodër/ Kushte më të mira, por më pak studentë në konvikte! Vëzhgimi i Report Tv, dhomat janë bosh
Ergys Kavaja
5 Tetor, 16:38

Pusi i Fatimes dhe thesaret e fshehura të Shkodrës, 75-vjeçari eksplorues rrëfen të pathënat në 'Një nga ne': Ja çfarë më tha një banor
Xhensila Nako
4 Tetor, 20:31

Po vizitonte kalanë e Rozafës, vdes turisti slloven! U rrëzua aksidentalisht
4 Tetor, 20:30

VIDEO/ Asgjësohen 3520 bimë narkotike në fshatrat e Shkodrës, nuk dihen autorët
4 Tetor, 14:42

Po transportonte kanabis në bagazhin e makinës, arrestohet 30-vjeçari në Shkodër (VIDEO)
4 Tetor, 11:56



Dhunonte vjehrrin, nën hetim 39-vjeçarja në Shkodër
3 Tetor, 11:36

VIDEO/ 'Drogohen, bëjnë aheng me alkool dhe therin policë', Gardianët britanikë zbulojnë jetën e përditshme brenda burgut të Anglisë
2 Tetor, 19:59

'Pastrim parash, dhunë, drogë dhe trafikim njerëzish', në vetëm 10 ditë, mbi 200 shqiptarë paraqiten në gjykatat e Britanisë
2 Tetor, 15:44

Nisi viti i ri akademik në Shkodër, studentët interes për Infermierinë, vetëm 1 student regjistrohet për Histori
2 Tetor, 11:27

'Daily Mail': Lidhjet e Dritan Rexhepit dhe organizatave kriminale shqiptare me mafiet ndërkombëtare
1 Tetor, 22:21

Kodi Etik Kontakt Rreth Nesh Raportoni Ju

© 2011 - 2023 Shqiptarja.com - Ndalohet riprodhimi i paautorizuar i kesaj faqeje